URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 163, datë 6.6.2022

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", të ndryshuar; të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre", ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit.

2. Komiteti Sektorial TIK organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:

a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sektorin e hoteleri-turizmit;

ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të hoteleri-turizmit, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin hoteleri-turizëm, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit hoteleri-turizëm, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;

e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore e në sektorin hoteleri-turizëm;

ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtari me më shumë eksperiencë në çështjet e hoteleri-turizmit dhe në zhvillimin e zbatimin e KSHK-së.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për përzgjedhjen e përfaqësuesve respektivë, sipas germave "a", "b" dhe "c", të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për përzgjedhjen e përfaqësuesit sipas germës "dh", të pikës 2 të këtij urdhri, në bazë të kritereve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve sipas shkronjave "ç", "d", "e" dhe "ë", të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja e tij në fuqi.

6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti i Mikpritjes dhe Turizmit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE

DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi